

**STATUTI I SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“Golden Foods” SH.P.K.**

**KREU I**

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**NENI 1**

Sot me daten 22.09.2020, ne baze te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregetare” I ndryshuar dhe Ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, themelohet shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin. **“Golden Foods” SH.P.K.**

Vendosem të hartojë këtë Statut, mbështetur në parimet e mëposhtëme:

**KREU II**

**EMRI, STATUTI, SELIA, KOHEZGJATJA**

**NENI 2**

Formohet shoqëria tregëtare e emërtuar **“Golden Foods”** sh.p.k. dhe me themelues:

- **Katerina Koci** , e bija e Fane , e datëlindjes 09.06.1941, lindur dhe banuese ne Dhoksat, Gjirokaster me ID E15609069I
- **Viktor Bashari**, i biri i Pandeli, i datlindjes 01.09.1974 lindur dhe banues ne Gjirokaster me ID H40901079D

**NENI 3**

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe do të përballojnë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të tyre të nëshkruara për kapitalin.

**NENI 4**

Shoqëria e ka seline e saj në Gjirokaster, Njesine Administative Lunxheri, Fshati Dhoksat, Zk1484 Nr 442/3

Me miratim te organeve të saj kompetente ajo mund të ndryshojë selinë. Mund të hapë degë, filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e R.SH apo jashtë saj.

**NENI 5**

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pa caktuar.



### KREU III

### OBJEKTI

#### NENI 6

Objekti i Veprimtarisë është:

- Import – Eksport i lendeve të para për prodhim Buke, Prodhime të ndryshme Embelsirash, Prodhime të ndryshme Brumi, Recelrash dhe Cokollate
- Prodhim dhe pakëtim i të gjitha produkteve të brumit, recelit, cokokremit
- Import – Eksport i të gjitha produkteve ushqimore
- Tregëtim me shumicë dhe pakicë e të gjitha produkteve ushqimore
- Përpunim dhe tregëtim i e gjitha llojeve të frutave dhe perimeve
- Import- eksport i makinerive dhe pajisjeve për prodhim ushqimor, pajisje elektrike dhe ndërtimore etj.

### KAPITALI

#### NENI 7

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lek dhe përbëhet nga 2 kuota nga 50.000 Lekë secila

Emri	Kuota (pjesë)	Shuma e kapitalit /leke	Perqindja %
Katerina Koci	1	50.000	50%
Viktor Bashari	1	50.000	50%

Kapitali themeltar është tërësisht në para. Të gjitha kuotat e kapitalit themeltar janë nënshkruar dhe shlyer krejtësisht nga ortakët themelues. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve, por asnjherë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin ligjor.

#### NENI 8

#### KUOTAT E KAPITALIT

Kuota e kapitalit të shoqërisë mund të zotërohet nga një ose më shumë persona.

Në rastin kur një kuotë e kapitalit të shoqërisë zotërohet nga më shumë se një person, në marrëdhënie me shoqërinë këta persona trajtohen si një ortak dhe të drejtat e tyre ushtrohen, nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët. Këta persona përgjigjen personalisht dhe në mënyrë solidare për detyrimet që lindin nga zotërimi i kuotës.

Veprimet e shoqërisë ndaj kuotës së zotëruar nga më shumë se një person krijojnë pasoja ndaj të gjithë zotëruesve të saj edhe nëse veprimi i

shoqërisë i drejtohet vetëm njërit prej zotëruesve.  
Shoqëria mund të lëshojë një certifikatë për të vërtetuar zotërimin e kuotës së kapitalit. Kjo certifikatë lëshohet në emër të personit apo të personave, që zotërojnë kuotën dhe nuk përbën letër me vlerë.

## **NENI 9 MËNYRAT E FITIMIT DHE KALIMIT TË KUOTAVE**

Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Ortaku mund t'u shese të tretëve kuotat e tije të kapitalit pjesërisht ose tërësisht, por mbasi tuia kete ofruar për blerje ortakevë brenda shoqërisë me kushte jo më pak të favorshme nga ato që do j'u ofrohen të tretëve. Oferta u komunikohet me shkrim ortakëve të cilët kanë të drejtën e parablerjes, e drejtë të cilën duhet ta ushtrojnë brenda 30 ditëve nga data e komunikimit në të kundërt oferta konsiderohet e refuzuar prej ortakëve që gëzojnë këtë të drejtë.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit në QKB.

Kuotat janë të papjestueshme.

Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

## **KREU IV**

### **ORGANET E SHOQËRISË**

#### **NENI 10**

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- Asambleja e përgjithshme
- Administratori

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

### **ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

#### **NENI 11 KOMPETENCAT**

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të çështjeve të mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorit;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të këtij neni;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) të kryejë detyra të tjera të parashikuara nga ligji.

## **NENI 12**

### **MBLEDHJA E ASAMBLESË**

Asambleja e përgjithshme është organi më i lartë vendimor. Ajo mbledhet sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë si dhe për të gjitha rastet e parashikuara në nenin 82 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 për "Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare". Asambleja e përgjithshme thirret nga administratori ose ortatakët në se ka. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

## **NENI 13**

### **THIRJA DHE VENDIMARRJA NË ASAMBLE**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të

mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës (shumicë e kualifikuar), për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për çështjet e tjera të renditura në nenin 11 të këtij Statuti, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Të gjitha vendimet e Asamblesë regjistrohen në procesverbal i cili përmban datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

## **ORGANI ADMINISTRATIV**

### **NENI 14**

Administratori i parë i shoqërisë " " sh.p.k. është Petro Koci me ID G10505036B. Afati 5 vjet nga data e emerimit.

### **NENI 15**

#### **KOMPETENCAT**

Asambleja e Përgjithshme emëron administratorin e shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhje.

Administratori ka këto kompetenca:

- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) të përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesi këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) të kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) të raportoj përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

Administratori është kompetent edhe për të:

- realizuar mbledhjen e asamblesë duke njoftuar ortakët me shkrim jo më vonë se 7 ditë më parë;

- propozuar strukturen e aparatit te shoqërisë;
  - marrë në punë persona të ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta;
  - propozuar rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme.
- Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

## KREU V

### PRISHJA E SHOQËRISË

#### NENI 16

Shoqëria **"Golden Foods" sh.p.k** prishet:

- a) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në QKB;
- ç) me vendim të gjykatës;

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë sjell hapjen e procedurave të likuidimit. Gjate fazes se likuidimit emrit te shoqerise i shtohet pjesa "Ne likujdim" qe shenohet ne te gjitha dokumentet qe shoqeria nxjerr gjate kesaj perjudhe.

Likujduesi i emeruar nga Asambleja e Përgjithshme, kerkon çregjistrimn e shoqerise prane QKB, pas shperndarjes se aktiveve te mbetura te shoqerise.

### VITI FINANCIAR

#### NENI 17

Ne perputhje me ligjin shoqeria do te kete nje regjister ne te cilen mbahen balance vjetore, raporte financiare vjetore dhe cdo kerkese tjeter ligjore.

#### NENI 18

Viti financiar i shoqerise fillon ne 1 janar te cdo viti kalendatik dhe perfundon ne 31 dhjetor te po ketij viti me perjashtim te vitit te regjistrimit ku viti financiar fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise dhe perfundon ne 31 dhjetor.

### DIVIDENTËT

#### NENI 19

Pas miratimit te bilancit vjetor dhe shperndarjes se te ardhurave, Asambleja percakton shumen qe do te ndahet si dividente, bazuar ne kuotat qe zoteron çdo ortak.

### PARASHIKIME PERFUNDIMTARE

**NENI 20**  
**NENSHKRIMI I KAPITALIT TE ORTAKËVE**

Kapitali i ortakëve nenshkruhet dhe ekzekutohet ne perputhje me kuotat respektive te ortakëve te shoqerise si me poshte:

Nr	Emri	Perqindja kuotave	e	Nr i kuotave
1	Katerina Koci	50 %		1 kuote
2	Viktor Bashari	50 %		1 kuote

**NENI 21**

Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij statuti, dhe aktit bashkëlidhur dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin ne Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria ka vulen e vete ne te cilen shkruhet emri i shoqerise sic e prashikon ligji.

Per ato qe nuk jane parashikuar ne kete statut zbatohen dispozitat e ligjit.

Statuti eshte hartuar ne 4 (kater) kopje origjinale me te njejten fuqi ligjore.

Dhoksat me 22.09.2020

**ORTAKET**

Viktor Bashari

ВИКТОР БАШАРИ



Katerina Koci



